



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|------------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI - | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI - | Anëtare |
| Rezarta | BITRI - | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 12614, datë 28.06.2019, informon problematikat e gjashtë QV, të cilat janë adresuar edhe nga KZAZ nr.6, Bashkia Vau Dejës.

Për të gjashtë Qendrat e Votimit i propozon KQZ-së të autorizojë ndryshimin e vendndodhjeve.

Prefekti i Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 12626, datë 28.06.2019, bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në vlerësim të situatës aktuale, edhe kushteve të ambienteve, por edhe mospranimit të vënies në dispozicion të ambienteve, sipas verifikimeve të kryera nga KZAZ nr.27, i propozon KQZ-së të autorizojë ndryshimin e vendndodhjeve të 21 QV-ve.

Kryetari i Bashkisë Bulqizë, me shkresën nr. 12628, datë 28.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1088, ku votojnë zgjedhësit e fshtrave Godvi, Krajkë dhe Sofracan. Për shkak se Shkolla 9 -vjecare Godvi, ku është



caktuar kjo QV, është në rikonstrukcion, Kryetari i Bashkisë kërkon dhënie autorizimi për vendosjen e QV nr. 1088 në Shkollën Fillore Sofracan.

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr.6, nr.27, nr.18 të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |

